

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-176/13

**Prishtinë
22 Prill 2015**

Në çështjen juridike të
R. K.

Serbi

Paraqitësi i kërkesës/pala ankuese

kundër

V. F.

Mitrovicë

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Esma Erterzi, dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/180/2012 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA56736, KPA56739 dhe KPA92850 të datës 14 dhjetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 22 Prill 2015, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga R. K., të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-176/2013, GSK-KPA-A-177/2013 dhe GSK-KPA-A-178/2013, bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-176/2013.
2. Refuzohen si të pabazuara ankesat e R. K. të paraqitura kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/180/2012 të datës 14 dhjetor 2012, në lidhje me kërkesat e regjistruara në AKP me numrat KPA56736, KPA56739 dhe KPA92850.
3. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/180/2012 i datës 14 dhjetor 2012, në lidhje me kërkesat e regjistruara në AKP me numrat KPA56736, KPA56739 dhe KPA92850.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 3 dhjetor 2007, R.K. (më tutje: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur tri kërkesa të ndara në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), të regjistruara me numrat KPA 056736, 56739 dhe 92850, duke kërkuar vërtetimin e së drejtës së pjesës ideal dhe ri-posedimin të ngastrave me numrat 403, 404 (KPA56736) te vendi Kiseli Ptok/POD K dhe ngastrave nr. 398, 399, 400, 401 (KPA56739 dhe KPA92850 të ndara nga 56739) te vendi Kiseli Potok/Jezer, në të cilën ndodhet një shtëpi (më tutje: pronat e kërkuara).
2. Në kërkesat thuhet se posedimi ndaj pronave të kërkuara ishin humbur për shkak të rrethanave që ndërlikohen me konfliktin e armatosur që kishte ndodhur në Kosovë në periudhën 1998/99, duke cekur 12 qershorin e vitit 1999 si datën e humbjes. Paraqitësi i kërkesës shtoi se të gjitha objektet në ngastrën 398 ishin shkatërruar gjatë vitit 1999.
3. Së bashku me kërkesën, ai ka paraqitur fletën poseduese nr. 19 të lëshuar nga Republika e Serbisë, Enti Republikan i Gjeodezisë, Kadastrit i Pronave të Paluajtshme Vushtrri, Komuna Kadastrale Sllatinë të lëshuar më 18 qershor 1996, që konstaton se të gjitha pronat e kërkuara janë të regjistruara në emrin e S. (Z.) K.. Ai po ashtu ka paraqitur procesverbalin e seancës dëgjimore të mbajtur në

Gjykatën Komunale të Mitrovicës më 25 maj 1998, në lëndën C. Nr. 240/96. Procesverbali pasqyron një ujdi gjyqësore ndërmjet M.S., M. M., T. O. dhe R. K. me palën përgjegjëse në kërkesë, K.Z., ku të lartpërmendurit japin 4/12 të pjesëve ideale të pronave të paluajtshme të regjistruara në fletën poseduese nr. 19 S. M., ndërsa në anën tjetër paraqitësi i kërkesës, R.K. merr 3/12 pjesë të pronës së njëjtë të paluajtshme në fletën poseduese nr. 19 dhe Z. K. merr 5/12 pjesë të saj.

4. Ujdia Gjyqësore është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive AKP-së. Sa i përket fletës poseduese nr. 19, është gjetur nga AKP-ja, në departamentin e kadastrit në Vushtrri, se vetëm ngastrat 193, 382 dhe 384 janë të regjistruara në emrin e personit të njëjtë (S. K.) ndërsa ngastrat 398, 399, 400, 401, 403 dhe 404 u gjetën të regjistruara në emrin e K. F. nën fletën poseduese nr. 127.
5. Më 22 korrik 2010, AKP-ja identifikoj pronat e kërkuara duke i publikuar në Gazetën e Njohimeve nr.5. Gazeta dhe Lista janë lënë te udhëheqësi i fshatit i cili pranoi që ato t'iu lë në dispozicion të palëve të interesuara, si dhe në hyrje dhe dalje të fshatit Sllatinë. Publikimet e njëjta janë lënë po ashtu në Komunë, Zyrën Kadastrale, Gjykatën Komunale në Vushtrri, zyrën regjionale të AKP-së në Mitrovicë, si dhe në OSBE, UNHCR, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe te Ombudspersoni.
6. Më 5 korrik 2011, V. (K.) F., ka paraqitur një njoftim të pjesëmarrjes duke pretenduar të drejtën mbi pronat dhe ka marrë pjesë në procedurën pranë AKP-së duke i kontestuar pretendimet e paraqitësit të kërkesës.
7. Për ta mbështetur pretendimin e tij, pala përgjegjëse në kërkesë ka paraqitur Çertifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme UL- 70202061-00127 të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Zyra Kadastrale Komunale Vushtrri më 20 tetor 2008 që konstaton se ngastra 398 te vendi Kiseli Potok/Avlija, ngastrat nr. 399, 400,401, te vendi Kiseli/Pod Kuqu dhe ngastrat nr. 403, 404 te vendi Kiseli Potok/Jezero janë të regjistruara në emër të K. F., babait të tij.
8. Më 14 dhjetor 2012 , KKPK-ja me Vendimin e vet KPCC/D/A/180/2012 i hodhi poshtë kërkesat bazuar me nenin 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.
9. Vendimi i KKPK-së iu dërgua R. K. (më tutje: pala ankuese) më 22 maj 2013. Më 10 qershor 2013, ai u ankua ndaj vendimit në Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme. Ankesa iu dorëzua palës përgjegjëse në ankesë më 25 tetor 2013; megjithatë, ai nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Pretendimet e palëve

Pala ankuese

10. Pala ankuese deklaroi se vendimi i KKPK-së përmban gabim thelbësor apo shkelje të rëndë të së drejtës materiale dhe se vendimi mbështetet në vërtetimin e gabuar apo të mangët të fakteve.
11. Sipas palës ankuese, me vendimin e kundërshtuar i KKPK-së janë refuzuar kërkesat e tij. Ai thekson se ka aplikuar në gjykatën kompetente për të kërkuar anulimin e kontratës së blerjes të bërë ndërmjet nipit të tij, Z.K., dhe K. F. e jo për konfirmimin e të drejtës pronësore ndaj pronave të kërkuara. Prandaj, ai pohon se të dy kërkesat nuk janë kontesti i njëjtë, kështu që neni 18 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 nuk zbatohet për kërkesat e tij të paraqitura në AKP.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

12. Ankesat janë paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh të paraparë me Ligjin nr. 03/L-079 neni 12.1 dhe ato janë të pranueshme. Kolegji i Apelit të AKP-së ka juridiksion për t'i shqyrtuar ankesat.

Bashkimi i ankesave:

13. Me nenin 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 parashihet se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkruara, kur për bashkimin apo shkrirjen e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të ligjit. Ky nen i mundëson Komisionit që të marrë në konsideratë bashkimin ose shkrirjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.
14. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të cilat janë të zbatueshme në procedurën pranë Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pastaj ato të nenit 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, parashikojnë mundësinë e bashkimit me aktvendim të të gjitha padive nëse ky bashkim i kontribuon efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.
15. Në tekstin e ankesave të parashtruara nga ana e ankuesit, Gjykata Supreme konstaton se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën saktësisht ushtrohet ankesa përkatëse, e gjitha baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave është plotësisht e njëjtë në të 2 (dy) lëndët. Vetëm ngastrat, objekte të së drejtës pronësore të cilat pretendohen në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më shumë edhe arsyetimi ligjor i dhënë nga ana e Komisionit për kërkesat është i njëjtë.

16. Ankesat e regjistruara nën numrat GSK-KPA-A-176/13 to GSK-KPA-A-177/13, të tri lëndët, janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar nën numrin GSK-KPA-A-178/13.

Meritat e ankesës

17. Sipas nenit 3.1 të Ligjit 03/L-079, KKPK ka kompetencë për t'i zgjidhur kërkesat që janë të lidhura me konfliktin duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Paraqitësi i kërkesës duhet të paraqes jo vetëm një titull pronësie ndaj pronës së paluajtshme private por gjithashtu të dëshmojë se ai apo ajo aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejta të tilla pronësore për shkak të rrethanave që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur.
18. Nga provat e paraqitura para KKPK-së, rezulton se pronat e kërkuara, të cilat ishin të regjistruara në emër të S. K., ishin ndarë në pjesë ideale nëpërmjet një marrëveshjeje gjyqësore ku 3/12 e pjesëve i janë dhënë palës ankuese, 4/12 motrës së tij S. M. dhe 5/12 Z. K., djalit të vëllait të tij.
19. Pala përgjegjëse në kërkesë paraqiti një kontratë të blerjes Vr.Nr.862/2004 të datës 1 shtator 2004, e lidhur ndërmjet babait të tij K. F. dhe Z. K., si (gjoja) person i autorizuar. Ai po ashtu dorëzoi çertifikatën që konstaton regjistrimin e tyre në kadastër nën emrin e babait të tij.
20. Pala ankuese kundërshton se nipi i tij Z. K. ka pasur të drejtë për t'ia shitur pronat e kërkuara K.F.. Sidoqoftë, ky pretendim, së pari, përfshin një kontest që nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur. Kjo sepse kontesti përfshin një kontest familjar mbi atë nëse i ishte dhënë autorizimi shitësit ose jo, pra nipit të palës ankuese, dhe çka është më e rëndësishme kontrata e blerjes është bërë në vitin 2004, shumë kohë pas konfliktit. Rrjedhimisht, humbja e posedimit të pronave të kërkuara nuk buron nga konflikti i armatosur por nga fakti se njëri nga trashëgimtarët kishte bërë një kontratë të shitblerjes në vitin 2004 e cila është juridikisht e vlefshme.
21. Në anën tjetër, pala ankuese veç ka paraqitur kërkesë pranë gjykatës kompetente për anulimin e kontratës (të bërë në vitin 2004) me 1 qershor 2006, para se t'i paraqes kërkesat aktuale pranë AKP-së. Pala ankuese pretendon se ai kërkon nga AKP-ja kthimin e posedimit të pronës së kërkuar ndërsa nga gjykata kërkon anulimin e kontratës së shitjes, prandaj këto janë dy konteste të ndryshme. Gjykata Supreme nuk e mbështet këtë argument. Të dy kërkesat e kanë qëllimin përfundimtar të njëjtë. Në qoftë se Gjykata komunale anulon kontratën – në fakt, ajo e ka refuzuar kërkesën kundër së cilës është paraqitur një ankesë dhe është në pritje – regjistrimi i titullarit të pronësisë në kadastër do të kthehet në pozitën e mëparshme. Prandaj, paraqitësi i kërkesës ka mundur ta gëzojë titullarin e tij të bashkë-pronësisë dhe posedimin apo të merr masa të domosdoshme në institucionet relevante për ri-posedimin e pronave të kërkuara nëpërmjet ekzekutimit të atij aktgjykimi. Kontesti është në

pritje para gjykatës kompetente. Ai është paraqitur para hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Rrjedhimisht, KKPK-ja ka qenë korrekte që ta konsiderojë çështjen të përjashtuar nga juridiksioni i KKPK-së për shkak të nenit 18 të Rregullores së cekur, sepse mjeti i kërkuar aty me siguri do të çonte në mjetin e kërkuar nga KKPK-ja, pra, titullarin e bashkëpronësisë dhe ri-posedimin e pronave të kërkuara.

22. Megjithatë, kërkesa duhet të hidhet poshtë gjithsesi jo vetëm për shkak të nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-79, që përjashton juridiksionin e KKPK-së, por edhe për shkak të faktit se humbja e posedimit të pronave të kërkuara nuk ka rrjedhur nga rrethanat që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo që burojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, por si rezultat i kontratës për blerje private të bërë në vitin 2004, nga njëri prej bashkë-pronarëve që pretendonte se ishte personi i autorizuar për të gjithë.
23. Gjykata Supreme konstaton se vendimi i ankimor është i drejtë dhe i ligjshëm, të bazuar në një procedurë të hollësishme dhe korrekte për hedhjen poshtë të kërkesave.
24. Nga pikëpamja e të lartcekurave, në përputhje me nenin 13.3 pika (c) e Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Ky aktgjykim nuk e paragjykon rezultatin e procedurës që është duke vazhduar pranë gjykatave vendore.

Këshillë ligjore

25. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është përfundimtar dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të zakonshme apo të jashtëzakonshme.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Esmat Erterzi, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it